



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.01.2025, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD.HOC PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSËDREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/eve dhe zëvendës drejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për konkursin Nr.01-111/01-4413 të datës 24.01.2025, në përbërje si vijon:

1. Besarta Trolli, DKA, Kryesuese
2. Raif Sadiku, Drejtor në SHFMU "Emin Duraku" Banullë, anëtar dhe
3. _____ Caktohet nga MASHT, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/es së IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (ieaa) të arsimit parauniversitar.
2. Mandati i anëtarëve është i përkohshëm ad.hoc dhe vlenë vetëm për konkursin Nr.01-111/01-4413 të datës 24.01.2024 të shpallur nga Komuna e Lipjanit.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-4917
Lipjan, më 28.01.2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

